



SHOQATA KOMBETARE E TRANSPORTIT QYTETAS

Datë, 22/05/2026

KËRKESE

Kërkues: Shoqata Kombëtare e Transportit Qytetas, me nipt K42407012T, me adresë Rruga “Llazi Miho” Nd. 6,Sh. 1, Kat 1, Kombinat, Tiranë.

Të dhënat elektronike të kontaktit (neni 154/2/a i KPC) Tel: **068 4030111**

LËNDA: Kërkesë për informacion dhe sqarim mbi zbatimin e detyrimit për pajisjen me POS/POI në transportin publik qytetas.

DREJTUAR: DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË TATIMEVE

KRYEMINISTRISË

Ministër i Shtetit për Pushtetin Vendor

Z.Ervin DEMO

BASHKISË TIRANË

Kryetar

Zj.Anuela RISTANI

Drejtor i Përgjithshëm i Punëve Publike

Z.Enton PUNAVIJA

MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

Z.Enea KARAKACI

MINSITRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË

Z.Petrit MALAJ

MINSITRISË SË EKONOMISË DHE INOVACIONIT

Zj,Delina IBRAHIMAJ



SHOQATA KOMBETARE E TRANSPORTIT QYTETAS

Të nderuar,

Shoqata Kombëtare e Transportit Qytetas, në kuadër të përmbushjes së detyrimeve ligjore dhe kontraktuale për ofrimin e shërbimit të transportit publik për kategoritë sociale që përfitojnë transport falas apo me tarifë të reduktuar, si dhe në funksion të përlogaritjes së kostove reale të operimit të këtij shërbimi, ju drejtohet me këtë kërkesë për informacion.

Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, konkretisht në nenin 3 të tij, i cili parashikon se:

- 1. Çdo person gëzon të drejtën e njohjes me informacionin publik pa u detyruar të japë arsye;*
- 2. Autoriteti publik është i detyruar të informojë kërkuesin nëse disponon informacionin e kërkuar;*
- 3. Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik në formën që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e tij.*

Shoqata Kombëtare e Transportit Qytetas, në përfaqësim të operatorëve të transportit publik urban në Republikën e Shqipërisë, ka marrë dijeni mbi njoftimin e Administratës Tatimore lidhur me detyrimin për pajisjen me pajisje POS/POI për subjektet që operojnë në sektorin e transportit. (tatime.gov.al) Nisur nga rëndësia e zbatimit korrekt të këtij detyrimi dhe specifikat që paraqet sektori i transportit publik qytetas, kërkojmë informacion dhe sqarime shtesë mbi mënyrën konkrete të implementimit në praktikë.

Transporti publik urban funksionon mbi një model me volum shumë të lartë transaksionesh dhe vlerë shumë të ulët për çdo pagesë individuale, ku aktualisht tarifa e biletës së transportit publik qytetas është vetëm 40 lekë për udhëtar. Në këto kushte, aplikimi i pagesave elektronike përmes POS/POI sjell një kosto të konsiderueshme financiare dhe operative për operatorët e transportit publik. Sipas tarifave të komunikuara nga institucionet bankare për shërbimin POS/POI, rezultojnë këto kosto:

- i. Komision për transaksionet me karta VISA/MasterCard kombëtare: deri në 2.70% për çdo transaksion;
- ii. Komision për karta ndërkombëtare: deri në 3.20% për çdo transaksion;
- iii. Tarifë fikse për çdo transaksion: 30 lekë / 0.30 euro;
- iv. Komision instalimi terminali POS: 5,000 lekë;
- v. Komision mirëmbajtje mujore terminali POS: 1,000 lekë/muaj;
- vi. Komision mos-përdorimi terminali POS: 1,000 lekë/muaj;
- vii. Kosto e terminalit POS në raste kontraktuale: deri në 50,000 lekë;
- viii. Komision për procedura “chargeback”: 500 lekë për rast.



SHOQATA KOMBETARE E TRANSPORTIT QYTETAS

Duke marrë në konsideratë faktin që një biletë urbane kushton vetëm 40 lekë, rezulton se vetëm tarifa fikse prej 30 lekësh për transaksion përbën pothuajse të gjithë vlerën e biletës, pa përfshirë komisionet përqindëse dhe kostot e tjera operative. Në këto kushte, implementimi i këtij sistemi paraqet paqartësi serioze mbi realizueshmërinë ekonomike të tij në transportin publik qytetas. Për këtë arsye kërkohet sqarim mbi çështjet e mëposhtme:

1. A do të jetë i detyrueshëm instalimi i pajisjeve POS/POI në çdo autobus urban individual apo në pika të tjera shërbimi të operatorëve?
2. Si parashikohet të realizohet procesi i pagesës me kartë në autobusët urbanë, duke pasur parasysh fluksin e lartë të pasagjerëve dhe kohën shumë të kufizuar të qëndrimit në stacione?
3. A janë përcaktuar norma apo tavane mbi komisionet bankare për transaksionet e kryera përmes POS/POI për sektorin e transportit publik?
4. Duke qenë se vlera e një bilete është vetëm 40 lekë, kërkohet sqarim nëse komisionet dhe tarifat do të rëndojnë mbi operatorët, mbi qytetarët apo do të subvencionohen nga shteti.
5. A parashikohet ndonjë mekanizëm mbështetës financiar nga shteti për pajisjen me terminale POS/POI dhe kostot e mirëmbajtjes së tyre?
6. A ekziston një model i unifikuar elektronik pagesash (kartë abonimi, QR, kartë elektronike qytetare, aplikacion celular apo sistem tjetër), i projektuar posaçërisht për transportin publik?
7. A është parashikuar periudhë tranzitore për sektorin e transportit publik, duke marrë parasysh nevojën për investime teknike, trajnime dhe përshtatje të infrastrukturës?
8. A do të ketë udhëzime specifike për trajtimin fiskal dhe procedurat e lëshimit të biletave elektronike në këtë sektor?

Shoqata vlerëson nismat për formalizim dhe modernizim, por konsideron se zbatimi në sektorin e transportit publik qytetas kërkon analizë të veçantë teknike dhe ekonomike, për shkak të natyrës së shërbimit, tarifave shumë të ulëta dhe numrit shumë të lartë të transaksioneve ditore.

Në pritje të një përgjigjeje dhe sqarimi zyrtar, me qëllim informimin e operatorëve dhe shmangien e problematikave gjatë zbatimit praktik.

Shoqata Kombëtare e Transportit Qytetas

KRYETAR
Kostandin Foni
